



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljenj/Predata Received/Delivety	09.12.2020	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	3052/2020		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.325/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Ardita Haxhnikaj Demikryetare Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë,- anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr.325/2020, të datës 27.10.2020, së ankuesit me adresë banimi Rruga „ Bulevardi i Dëshmoreve e Kombit“, hyrja 2 nr. 25, nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Tregtisë dhe Indusisë, në çështjen juridike “ kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 09.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.325/2020 e datës 27.10.2020 e parashtruar nga ankuesi
- II. DETYROHET** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë që të ndërmarr veprimet e duhura procedurale të përcaktuara me legjislacionin në fuqi që rregullon çështjen e shtesave për kushtet specifike në punë, për ankuesin, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

A r s y e t i m

, Inspektor i Tregut, më datë 23.10.2020 nëpërmjet postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e shtesës mbi pagën bazë për shkak të kushteve specifike të

punës, dhe harmonizimin e pagës nga koeficienti shtatë (7) në tetë (8). Ankesa e ankuesit është pranuar më datë 27.10.2020 dhe është protokolluar me numër Nr. Prot. 2279/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.11.2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë të Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Kjo e fundit më datë 10.11.2020 ka përcjell gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr.325/2020, e datës 27.10.2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 04.09.2020, i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë; Akt Emërimi i datës 18.10.2018; Përshkrimi i detyrave të Punës; Kërkesë e datës 04.09.2020; e-maili i datës 03.09.2020; lista e pagave; Aktvendimi i datës 28.02.2019, i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Aktvendimi i datës 01.09.2020, i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Raporti i Auditimit për vitin 2018; Lista e pagave; Autorizimi i datës 04.06.2018, i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë; Njoftimi i datës 05.07.2018; Vendimi i datës 04.11.2020; i Sekretares së Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë; kërkesë e datës 24.09.2020; e-maili i datës 04.11.2020; Përgjigje në ankesë e datës 10.11.2020, me numër protokoll 2536/2020, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesi është *pjesërisht e bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të Akt Emërimit të datës 18.10.2018, ka konstatuar se parashtruesi i ankesës mban pozitën e punës Inspektor i Tregut, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Ankuesi ka parashtruar ankesë kundër mosveprimit gjegjësisht mos zbatimit të vendimit nr.5876 të datës 04.09.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm, për harmonizim të koeficientit të pagës nga shtatë (7) në tetë (8), dhe kundër mosveprimit në realizimin e shtesës në pagë për shkak të kushteve specifike në punë dhe punës jashtë orarit, siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-186 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, i publikuar në Gazetë Zyrtare me datë 10.05.2013.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për shtesën në pagë për shkak të kushteve specifike në punë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke analizuar legjislacionin në fuqi, ka konstatuar se dispozitat e Ligjit Nr.04/L-186 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, përkatësisht neni 10.A paragrafi 1 përcakton së: *"Inspektorëve të tregut i njihet e drejta e marrjes së pagesës shtesë mbi pagën bazë, për shkak të kushteve specifike në punë dhe punës jashtë orarit të punës"*, andaj, si rrjedhojë Kolegji për shqyrtimin e ankesave, vlerëson se ankuesit, respektivisht Inspektorëve të Tregut, sipas dispozitave të ligjit të veçantë, iu njihet e drejta e marrjes së pagesës shtesë mbi pagën bazë, për shkak të kushteve specifike në punë mirëpo duke u bazuar në paragrafin 2 të këtij neni ku përcaktohet së: *Shtesat sipas paragrafit 1. të këtij neni do të bëhet konform Ligjit përkatës për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjit përkatës për pagat e nëpunësve civil, Kolegji vlerëson se realizimi i shtesës për kushte specifike të punës për*

ankuesin mund të bëhet vetëm pas aprovimit nga institucionet përgjegjëse respektivisht Ministria përgjegjëse për administratë publike, siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 16 paragrafi 1, ku përcaktohet se: ... *institucioni kërkon miratimin e një shtese për kushte të punës për këta nëpunës civilë, sipas aktit nënligjor të përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni, si dhe dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, përkatësisht nenit 7 paragrafi 3 ku përcaktohet se ... për aprovimin e shtesës për kushte të veçanta, institucioni duhet t'i ofrojë Ministrisë përgjegjëse për Administratë Publike kërkesën që përmban: 3.1 arsyeshmërinë për pagimin e shtesës për kushte specifike të punës për pozitën (at) përkatëse; 3.2 listën e pozitave përkatëse, gradat dhe numrin e nëpunësve civilë për çdo pozitë; 3.3 detajet, sipas të cilave, secila pozitë përkatëse pritet të jetë e ekspozuar ndaj rrezikut; 3.4 koston vjetore të vlerësimit financiar të shtesave për kushte specifike të punës.*

Andaj, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit të bazës ligjore dhe konstatimit se me dispozitat e ligjit të veçantë ankuesit i është njohur e drejta në shtesë për kushte specifike në punë, vlerëson se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë duhet të ndërmarr veprimet e duhura procedurale për trajtimin e çështjes që është objekt i kësaj ankese, siç parashihet me dispozitat e nenit 16 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, si dhe dispozitat e nenit 7 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, në këtë kuptim Kolegji ka vendosur për aprovim të pjesshëm të ankesës dhe detyrimin e organit punëdhënës si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për njohjen e të drejtës për kompensimin e shtesës për kushte specifike të punës, në mënyrë retroaktive duke filluar nga data 18.10.2018, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Ligji Nr.04/L-186 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, është publikuar në Gazetë Zyrtare me datë 10.05.2013, ndërsa ankuesi ka parashtruar ankesë me datë 27.10.2020, andaj vlerëson se pretendimi ankimor për kompensimin e shtesës në mënyrë retroaktive është i pa bazuar për faktin se ankesa është parashtruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se; *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.*

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për harmonizimin e koeficientit të pagës nga shtatë (7) në tetë (8) sipas vendimit nr.5871 të datës 04.09.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave gjatë shqyrtimit të lëndës ka gjetur se ankuesi ka themeluar marrëdhënien e punës në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në pozitën e punës "Inspektor i Tregut" me koeficient të pagës shtatë (7), sipas Akt Emërimit të datës 18.10.2018. Po ashtu, bazuar në autorizimin e datës 04.06.2018 të lëshuar nga Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil, Kolegji ka konstatuar se koeficienti i pagës për këtë pozitë të punës ka qenë shtatë (7) dhe parashtruesi i ankesës me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës është pajtuar me kushtet e punësimit respektivisht koeficientin e pagës duke nënshkruar Aktin e Emërimit të datës 18.10.2018. Si rrjedhojë, Kolegji ka konstatuar se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe

Industriisë, përmes Vendimit nr.5871 të datës 04.09.2020 ka aprovuar kërkesën e ankuesit për harmonizim të koeficientit të pagës nga shtatë (7) në tetë (8), mirëpo me datë 03.11.2020 përmes vendimit me numër të protokollit 8251, ka pezulluar zbatimin e vendimit nr.5871 me arsyetimin se Ministria e Tregtisë dhe Industriisë nuk ka buxhet për harmonizimin e koeficientit të pagës. Andaj, duke marr parasysh se vendimi i lartcekur i organit të punësimit, në mungesë të buxhetit është pezulluar, Kolegji për shqyrtimin e ankesave vlerëson se pretendimi ankimor i ankueses është i pa bazuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në këto rrethana, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmarr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.325/2020

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industriisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Tregtisë dhe Industriisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

